



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në pajtim me nenin 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) dhe neneve 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në seancën e 55-të, të mbajtur me datë 17.11.2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-2540/1 të vitit 2021, e formuar pas denoncimit me numër 12-2540/1 të datës 22.07.2021, e dorëzuar nga parashtrues i panjohur, NDËRPRITET.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime të mëtejshme për faktin se lëndën në fjalë është vepruar nga organ tjetër kompetent dhe pretendimet në lëndë nuk janë konfirmuar.

Lënda me numër 12-2540 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2540 e vitit 2021 është formuar pas denoncimit të dorëzuar nga parashtrues i panjohur - ----, i regjistruar me numrin 12-2540 / 1. nga 22.07.2021, me pretendime për punë të paligjshme në ---- lidhur me procedurën aktuale për zgjedhjen e drejtorit të shkollës dhe parregullsi të tjera në punë. Lidhur me lëndën në fjalë, anëtarët e këshillit të shkollës në lëndën shkollë, ishte dërguar njoftim deri te organi tjetër kompetent, Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, duke e njoftuar për funksionimin e paligjshëm në lëndën e shkollës fillore dhe duke kërkuar veprime të menjëhershme dhe marrjen e masave të duhura dhe sanksionet ndaj të denoncuarve për shkak të veprimit të tyre joprofesional, të papërshtatshëm dhe të kundërligjshëm.

Për të verifikuar pretendimet në fjalë, KSHPK-ja ka dorëzuar kërkesë në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit për të dhënë të dhëna dhe informacione lidhur me pretendimet e denoncuar. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të siguruar, është konstatuar se për rastin në fjalë është vepruar nga organi tjetër kompetent i cili me ankesë të parashtruar nga anëtarët e këshillit të shkollës ka kryer inspektim të jashtëzakonshëm në lëndën e shkollës fillore dhe në bazë të gjendjes së konstatuar nuk janë konstatuar parregullsi, nga pretendimet e parashtruara në parashtrësë, dhe krahas kësaj shkresë është dorëzuar Procesverbali nga inspektimi i kryer nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Nga sa u tha më lart, KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtutjeshëm në këtë rast për faktin se në këtë rast është vepruar nga organ tjetër kompetent dhe nuk janë vërtetuar pretendimet në fjalë, pas çka ka vendosur si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Punoi: J.C.
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

